PAS RRËNIMIT TË SISTEMIT TË ARSIMIT NË KOSOVË, TË CILËN QË SERBIA E ARRITI ME ANË TË TANKEVE, TERRORIT DHE GJENOCIDIT NDAJ SHKOLLËS SHQIPE, RINIA SHKOLLORE NË BASHKËPUNIM ME DREJTORITË E SHKOLLAVE DHE INSTITUCIONEVE EDUKATIVO-ARSIMORE SINKRONIZOI DHE KOORDINOI PUNËT RRETH ORGANIZIMIT TË PROTESTAVE PËR LIRIMIN E SHKOLLAVE TË UZURPUARA ME DHUNË NGA OKUPATORI SERB.

QËLLIMI I ORGANIZIMIT TË PROTESTAVE ISHTE: QË OPINIONIT BOTËROR T'I BËHET ME DIJE SE NXËNËSIT, STUDENTËT, ARSIMTARËT DHE RINDËRIT SHQIPTAR NUK DO TË HEQIN DORË NGA OBJEKTET SHKOLLORE, UNIVERSITETI, INSTITUCIONET ARSIMORE, INSTITUCIONET KULTURORE DHE SHKENCORE TË SHQIPTARËVE.

QË OPINIONI BOTËROR MË NË FUND TË KUPTOI DHE OBJEKTIVISHT TË INFORMOHET PËR GJENDJEN TEPËR TË RËNDË TË ARSIMIT NË KOSOVË.

QË TË KONCENTROHET FORCA INTELEKTUALE DHE EMOCIONALE E MASAVE TË PËRGJITHËSHME POPULLORE PËR KTHIMIN E LOKALEVE DHE OBJEKTEVE SHKOLLORE.

PROTESTAT U SHUAN ME NJË TERROR TË EGËR NGA OKUPATORI SERB. ARSIMTARËT ARRESTOHESHIN NË OBORRE TË SHKOLLAVE, MALTRETOHESHIN NXËNËSIT DHE PRINDËRIT E TYRE, MIRËPO KJO NUK E FRIKSOI ASNJË ARSIMTAR, NXËNËS APO PRIND; POR PËRKUNDRAZI FILLOI EDHE NJË ORGANIZIM I RI PËR SHNDËRRIMIN E SHTËPIVE NË SHKOLLA. KËTË AKCION TERRORISTËT SERB TENTUAN TA DENGOJNË DUKE VRARË PRONARËT E SHTËPIVE SHKOLLA SIÇ ISHTE RASTI NË UÇË TE ISTOGUT DHE MALTRETIMI I TË GJITHË PRONARËVE TJERË TË SHTËPIVE SHKOLLA ME PRETEKS TË KËRKIMIT TË ARMËVE. ME HAPJEN E SHTËPIVE SHKOLLA U RUAJT KONTINUITETI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE, KULTURORE DHE SHKENCORE TË KOSOVËS.

RINIA SHKOLLORE SI FORMË E RE E VEPRIMIT, DUKE U NISUR NGA FAKTI I RRËNIMIT TË ARSIMIT NË KOSOVË NXJERRE: RREGULLOREN ORGANIZATIVE TË RSH., PROGRAMIN E RSH DHE RREGULLOREN PËR MBAJTJEN E KUVENDIT ZGJEDHOR TË RSH I CILI MBAHET NË 25.12.1993. NË MEDRESEN E MESME „ALAUDDIN" NË PRISHTINË.

PUNA E R.SH ËSHTË BËRË SIPAS PLAN PROGRAMIT QË ËSHTË APROVUAR NË KUVEND. NË PUNËN E VET RSH I KA KUSHTUAR KUJDES TË VEÇANTË: PUNËS EDUKATIVO ARSIMORE; PUNËS SË BASHKËSISË SË NXËNËSVE TË PARALELËS, NË NIVEL TË KLASËVE, TË SHKOLLËS, KOMUNËS DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS; JETËS KULTURORO-ZBAVITËSE TË NXËNËSVE; ORGANIZIMIT TË GARAVE TË NDRYSHME NË TË GJITHA LËMIT DHE DISCIPLINAT TË TË PARAPARA ME PROGRAM TË PUNËS.

NË FILLIM TË ÇDO VITI SHKOLLOR ËSHTË SHQYRTUAR PROGRAMI I PUNËS SË RSH DHE PLAN-PROGRAMI MËSIMOR I SHKOLLAVE ME QËLLIM TË KOORDINIMIT TË PUNËS NË MES TË RSH DHE INSTITUCIONEVE EDUKATIVO-ARSIMORE.

GRUPET LETRARE, GRUPET E RECITUESVE, GRUPET E DRAMËS, GRUPET E VALLTARËVE, KORET E SHKOLLAVE DHE GRUPET E MUZIKËS ARGËTUESE PËRVEÇ PARA NXËNËSVE, PRINDËRVE, ARSIMTARËVE ME RASTIN E FESTAVE KOMBTARE JANË PREZENTUAR EDHE PARA PUBLIKUT TË QYTETIT NË PRISHTINË, PRIZREN, PLAVË, GUCI, VUTHAJ ETJ,

RSH NË BASHKËPUNIM ME KËSHILLAT KOMUNALE TË ARSIMIT (SEKRETARIATET KOMUNALE TË ARSIMIT) DHE FEDERATEN E SPORTEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS KA ORGANIZUAR GARAT SPORTIVE NË SHAH, BASKETBOLL, FUTBOLL TË VOGËL DHE PING-PONG.

RSH. NË BASHKËPUNIM ME KËSHILLAT E ARSIMIT DHE LASH-„NAIM FRASHËRI" KANË ORGANIZUAR GARAT E RECITUESVE NË NIVEL TË SHKOLLAVE, KOMUNAVE, KOSOVËS DHE NË NIVEL GJITHËKOMBËTAR NË PRESHEVË „PRESHEVA '95".

RSH NË BASHKËPUNIM ME TPK DHE TEATRIN E TË RINJËVE „DODONA" KA ORGANIZUAR VIZITAT KOLEKTIVE TË TEATRIT, EKSPOZITAVE TË KRIJIMTARISË FIGURATIVE DHE EKSPOZITËS SË FOTOGRAFIVE TË NXËNËSVE.

RSH NË BASHKËPUNIM ME SHKENCËTARË, POLITIKOLOGË, SOCIOLOGË, MJEK etj. KA ORGANIZUAR LIGJËRATA NË TEMA TË NDRYSHME ME INTERES PËR TË RINJË.

RSH. NË KUADËR TË AKSIONIT „PUNË, PUNË, NATË E DITË..." KA BËRË ANALIZËN E SUKSESIT, ANALIZËN E VIJIMIT ~~DHE~~ DICIPLINËS SË NXËNËSVE SI DHE RANGIMIN E SHKOLLAVE, KLASËVE, DHE NXËNËSVE MË TË MIRË NË BAZË TË REZULTATEVE TË ARRITURA.

RSH NË KUADËR TË MUAJIT TË HIGJENËS KA PUNUAR NË MIRËMBAJTJEN E PASTËRTISË SË OBORRIT DHE LOKALEVE TË SHKOLLËS.

RSH KA KOORDINUAR PUNËN ME TË GJITHA GRUPET, KLUBET, SHOQATAT, ME TË RINJËT E PARTIVE POLITIKE DHE ORGANIZATAT TJERA QË TUBOJNË RININ DHE FORMAT E ORGANIZUARA TË AKTIVITETEVE SHOQËRORE TË RINISË, QË E PRANOJNË PROGRAMIN E RSH.

EKIPET SHKOLLORE DHE KOMUNALE NË BASHKËPUNIM ME FORUMIN RINOR TË LDK-SË KANË ORGANIZUAR DHE MBAJTUR GARA, KUIZE TË DITURISË NË SHUMË DICIPLINA NË KUADËR TË MANIFESTIMIT „VULLNETI '94" DHE „VULLNETI '95"

RSH GJATË KËTIJ VITI SHKOLLOR DO TË RIAKTIVIZOJ, KRYQIN E KUQ, LIDHJEN E VËZHGUESËVE, KLUBET E TEKNIKVE TË RINJË DHE HULUMTUESIT E RINJË.